MARS 2021

NEWSLETTER

KOLEGJI AAB

FILLOI SEMESTRI VEROR 2020/21 NË KOLEGJIN AAB

AAB ANËTARËSOHET NË ASOCIACIONIN EVROPIAN TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË (ELFA)

VAZHDON BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETET NGA TURQIA

MAGNA CHARTA OBSERVATORY: AAB MORI PJESË NË TAKIMIN "UNIVERSITETET EVROPIANE 2030: VIZIONI DHE VLERAT"

FILLOI SEMESTRI VEROR 2020/21 NË KOLEGJIN AAB

Mesazhi i rektorit Bujar Demjaha me rastin e fillimit të semestrit veror 2020/21

Të nderuar studentë, mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë,

Kam kënaqësinë që kësaj radhe t' ju drejtohem sot, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, dhe menjëherë pas Ditës së Mësuesit 7 Marsit, duke ju uruar të dy festat e rëndësishme për ne, familjet tona dhe shoqërinë në përgjithësi.

Për neve në Kolegjin AAB, dita e sotme e ka edhe një veçanti tjetër, sepse sot po e fillojmë semestrin veror të vitit akademik 2020/21.

Nëse Kolegji AAB e ka studentin në qendër të vëmendjes, rrjedhimisht studenti i ka studimet në qendër të vëmendjes. Në këtë drejtim institucioni ynë ka bërë përgatitjet duke iu përshtatur maksimalisht kërkesave të studentit.



Kolegji AAB me të gjitha kampuset ne Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë dallohet me infrastrukturë me të cilën të gjithë së bashku mburremi. Si rrallë ndonjë institucion i arsimit të lartë, ne e kemi vendosur në masën më të madhe mësimin në objekte por detyrimisht një pjesë e mësimit mbetet të realizohet nga distanca, e disa grupe mësimin ta mbajnë edhe të dielave. Është gjendje e jashtëzakonshme dhe presim mirëkuptim nga të gjithë, stafi akademik e në veçanti nga studentët të kenë mirëkuptim dhe të bashkëpunojnë në këtë drejtim.

Të gjithë, pa dallim duhemi t' i respektojmë masat e qeverisë sonë të cilat kanë për qëllim parandalimin e zgjerimit të pandemisë. COVID-19 me të gjitha format e reja të tij është ende në mes nesh. Secili nga duhet t' i respektojmë masat jo vetëm për arsye që ligjërisht obligohemi por edhe me qëllim të mbrojtjes së më të dashurve që i kemi në shtëpi dhe më gjerë.

Studenti dhe mësimdhënësi është i obliguar që të:

– mbajë distancën,

– mbajë maskën si duhet tërë kohën sa qëndron në objekt. Mësimdhënësi mundet të largojë maskën kur ligjëron nëse mbanë distancën minimum 2m

– të pastrojë dhe dezinfektojë me rregull duart

STUDENTËT E KLUBIT TË DEBATIT TË FAKULTETIT TË GJUHËS ANGLEZE MBAJTËN DEBATIN E RADHËS

10 Mars 2021

Klubi i Debatit i Fakultetit të Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB zhvilloi seancën e radhës debatuese me temën "Rëndësia e Edukatës Qytetare në programin shkollor te të rinjtë?".

Debati u moderua nga koordinatorja e debatit, studentja Artiola Kajtazi, ndërsa në cilësinë e jurisë ishin mësimdhënësit: Mirsad Suhodolli, Aida Thaqi dhe Gresa Shaqiri.

Diskutimi filloi me një prezantim të shkurtër nga koordinatorja, e cila i informoi debatuesit dhe gjyqtarët në lidhje me formatin e debatit dhe ofroi informacion në lidhje me temën e edukatës qytetare. Studentët ngritën pyetje të tilla si: Cilat janë përfitimet e edukatës qytetare në shkolla?

? ? ?

Pse është i rëndësishëm edukimi seksual? Si ndikon kultura e një vendi në përfshirjen e edukatës qytetare si lëndë në shkolla? Çfarë duhet të mësohet në orët e edukatës qytatare? Në cilën moshë duhet të fillojnë të mësojnë studentët për edukatën qytetare? Çfarë lloj sistemi notimi duhet të përdorin mësuesit e kësaj lënde?

Anëtarët e jurisë vëzhguan diskutimin për kohëzgjatjen prej 90 minutash. Më pas, juria dha kontributin e saj dhe i informoi studentët në lidhje me performancën e tyre dhe dha këshilla se si ata të rrisin dhe përmirësojnë aftësitë e tyre debatuese edhe më tej në të ardhmen.

Në fund të diskutimit, juria shpalli ekipin pohues si fitues të debatit.

U PROMOVUA LIBRI "SUKSESI I MENAXHIMIT NË SHITJE" I ISH-STUDENTIT TË AAB-SË, SHPËTIM MEMISHI

15 Mars 2021

Në Kolegjin AAB u bë promovimit "Suksesi i menaxhimit në shitje", i autorit Shpëtim Memishi. Në këtë libër, autori Shpëtim Memishi përpiqet që në mënyrë të detajuar të pasqyrojë konceptet e menaxhimit të shitjes në përgjithësi dhe procesin vetefiçiencës menaxheriale të shitjes në veçanti.

"Suksesi i menaxhimit në shitje", është i ndarë në gjashtë pjesë dhe katërmbëdhjetë kapituj, ndërsa sjell një qasje krejtësisht praktike dhe përmes saj autori pasqyron ciklin e plotë të procesit të menaxhimit të shitjes, që nga faza planifikimit, organizimit, komunikimit, procesit dhe teknikave të negocimit e deri tek analiza dhe vlerësimi i shitjes.

Në fjalën e tij me rastin e promovimit të librit, profesori i Fakultetit Ekonomik, Ilir Rexhepi ndër të tjera tha se e veçanta e këtij libri në kontekst përmbajtësor, përveç kontekstit shkencor, është mënyra se si autori e gërsheton përvojën praktike me valorizimin e shembujve shpjegues, rasteve studimore, koncepteve, metodave, instrumenteve dhe teknikave te shitjes. Të gjitha këto në funksion të shitjes sa më të suksesshme.

"Ky libër është një instrument i shkathtësive me një qasje alternative, në përgjithësi praktike që do t' i shërbejë të gjithë studentëve dhe të interesuarve të tjerë nga fusha e menaxhimit të shitjes, që të avancojnë formësimin e tyre praktik profesional në funksion të menaxhimit të shitjes në përgjithësi, përkatësisht suksesit në procesin e shitjes së produkteve apo shërbimeve në veçanti", tha Rexhepi.

Ndërsa dekani i Fakultetit Ekonomik, Medain Hashani, e vlerësoi punën e autorit Shpëtim Memishi, duke nënvizuar se Memishi ka mbaruar studimet për ekonomi në të dy nivelet në Kolegjin AAB, dhe se kontributi i tij është i vazhdueshëm.

AAB ANËTARËSOHET NË ASOCIACIONIN EVROPIAN TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË (ELFA)

15 Mars 2021

Bordi i Asociacionit të Fakulteteve të Drejtësisë të Evropës (ELFA), ka marrë vendim për pranimin e Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, si anëtar me të drejta të plota të këtij asociacioni.

Falë angazhimit të dekanatit dhe mësimdhënësve të Fakultetit Juridik, ky sukses konsiderohet si shumë i rëndësishëm, duke marrë parasysh se Fakultetet e Drejtësisë në Evropë dhe në mbarë botën po përballen sot me një numër sfidash, siç janë: krijimi i sistemeve për krahasueshmërinë e arsimit të lartë dhe njohjes së mësimit të fituar në vendet e tjera, sigurimi i fondeve të përshtatshme për anëtarët, krijimi i vendeve të punës, lëvizja e studentëve dhe stafit, arsimi digjital, etj..

ELFA u themelua në vitin 1995 në Leuven të Belgjikës, nga më shumë se 80 fakultete të drejtësisë të universiteteve të ndryshme anembanë Evropës.

Misioni i ELFA është të përfaqësojë dhe promovojë interesat e anëtarëve të saj në fushën e edukimit juridik dhe kërkimit karshi institucioneve të BE-së, organizatave ndërkombëtare si dhe shoqatave të profesionistëve ligjorë.

Organizata momentalisht ka më shumë se 150 anëtarë nga vende brenda dhe jashtë BE-së dhe vepron si një forum ndërkombëtar për diskutimin e shumë temave ligjore lidhur me arsimin ligjor.

ELFA
European Law
Faculties Association

AAB NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN "ISA BOLETINI" NGA MITROVICA

15 Mars 2021

Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit akademik dhe promovimit të mirëkuptimit mes dy institucioneve të arsimit të lartë, Kolegji AAB dhe Universiteti "Isa Boletini" nga Mitrovica, nënshkruan sot marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshje e nënshkruar nga rektorët respektivë, Bujar Demjaha dhe Alush Musaj, u nënshkrua në ambientet e UIBM, ndërsa përmes saj do të specifikohen fushat e bashkëpunimit.

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, u shpreh se pret që bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve të jetë i frytshëm dhe të prodhojë rezultat të prekshëm.

Nga ana tjetër, rektori i UIBM, Alush Musaj, vlerësoi se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë brenda vendit është i domosdoshëm dhe tepër i nevojshëm, si për studentët ashtu edhe për stafin akademik.

Përmes marrëveshjes së arritur sot, pritet të krijohet partneritet në mes të palëve në fushën profesionale, arsimore dhe shkencore që përfshinë të gjitha programet e studimit të organizuara nga palët nënshkruese. Marrëveshja konsiston në bashkëpunimin profesional mes stafit akademik dhe administrativ, bashkëpunimin e studentëve të cikleve të ndryshme të studimit për periudha semestrale studimi ose për periudha të praktikave, aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor etj..

STUDENTËT E KOLEGJIT AAB SHËNUAN DITËN BOTËRORE TË POEZISË

21 Mars 2021

Në shënim të 21 Marsit, Ditës Botërore të Poezisë, studentët e Fakultetit të Gjuhës Angleze organizuan një manifestim artistik me poezi dhe këngë të interpretuara nga ta.Recitali u konceptua si një konkurs dhe juria përbëhej nga ligjërues të letërsisë, Prof. Xhavit Rexhaj, Prof. Venera Llunji, Prof, Albert Paçarizi, Kaltrina Pacolli dhe Andrin Kabashi.

Në fjalën e mirëseardhjes, Dekanja Aida Alla i përgëzoi studentët konkurrentë dhe u shpreh se aktivitete të tilla promovojnë leximin dhe rrisin pasionin për letërsinë.

Në fund të aktivitetit u ndanë dy çmime, Çmimi "Recituesi më i Mirë (The Best Reciter) dhe çmimi "Poeti i Gjeneratës" (Poet of the Generation). Çmimin e parë si recituesija me e mirë e fitoi studentja Adonita Kadriaj, ndërsa Çmimin "Poeti i Gjeneratës" iu dha studentes Jetmira Ajeti.

U SHËNUA 70 VJETORI I ARKIVAVE TË KOSOVËS

22 Mars 2021

Në ambientet e Teatrit AAB "Faruk Begolli" në Kolegjin AAB, me një akademi solemne sot u shënua 70 vjetori i Arkivave të Kosovës.

Në fjalën e tij, kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave, Bedri Zyberaj, foli për historikun por edhe gjendjen aktuale të Arkivit të Kosovës. Ai tha se në këtë rrugëtim 70 vjeçar, pavarësisht sfidave dhe vështirësive në të cilat ka hasur ky institucion, ka shënuar edhe të arritura që nuk mund të mohohen, duke mbledhur dokumente dhe dorëshkrime origjinale që shkojnë në një thellësi kohore prej afro 600 vjetësh.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, Ardit Bido, tha se arkivat tona i konsiderojmë pasuri të përbashkët kombëtare. Ai foli për bashkëpunimin e frytshëm të arkivave të dy shteteve, dhe tha se shembullin e bashkëpunimit të Arkivave të Kosovës e Shqipërisë do të ishte mirë ta ndiqnin edhe institucionet tjera të vendeve tona.

AUDITORI I PËRGJITHSHËM VIZITOI KOLEGJIN AAB PËR TË FORCUAR BASHKËPUNIMIN NDËR INSTITUCIONAL

22 Mars 2021

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Besnik Osmani, vizitoi Kolegjin AAB, ku u prit nga Rektori, z. Bujar Demjaha, Dekani i Fakultetit Ekonomik, z. Medain Hashani dhe prodekanja znj. Kosovare Ukshini. Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Kolegjit AAB në fushën e auditimit, shkëmbimet e ndihmës profesionale e akademike, si dhe të angazhimit të studentëve në punë praktike.

Në kuadër të kësaj vizite në Kolegjin AAB, Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, po ashtu, pati edhe një bashkëbisedim me studentët e Fakultetit Ekonomik, para të cilëve shpjegoi rolin, misionin, mënyrën se si funksionon Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe detaje të tjera rreth procesit të përpilimit të raporteve të auditimit.

Osmani ka thënë se ZKA-ja auditon fondet publike për t'i siguruar taksapaguesit që paratë e tyre po përdoren në mënyrë ekonomike, që raportimi financiar është i saktë dhe vendimet janë në pajtim me kërkesat ligjore. Tutje Auditori i Përgjithshëm ka theksuar rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe ndikimin e tyre në fuqizimin e qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies.

Nga ana tjetër studentët u interesuan që të informohen më shumë lidhur me atë se si bëhet auditimi, për sigurinë në auditim, llojet e auditimeve, për llogaridhënien dhe transparencën e shpenzimit të parasë publike.

Ndërkohë Dekani i Fakultetit Ekonomik në Kolegjin AAB, z. Medain Hashani, falënderoi Auditorin e Përgjithshëm për vizitën, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimi mes dy institucioneve. Hashani ka thënë se ZKA-ja vazhdon të jetë ndër institucionet më kredibile në Kosovë përmes punës profesionale, të pavarur dhe transparente.

PËRMIRËSIMI I EDUKIMIT DHE PRAKTIKAVE NË INFERMIERI NË PROCESIN E PANDEMISË COVID-19

24 Mars 2021

Në vazhdën e trajnimeve të planifikuara nga Kolegji AAB në bashkëpunim me Universitetin "DOKUZ EYLÜL" në Turqi, ju njoftojmë mbi aktivitetin e radhës i cili është i paraparë të mbahet me datën 01.04.2021.

Ky trajnim vë në pah edukimin e vazhdueshëm profesional, dhe si i tillë është edhe i akredituar nga Oda e Infermierëve të Kosovës. Pjesëmarrësit aktivë do të vlerësohen me 8 pikë, kurse pjesëmarrësit pasivë do të vlerësohen me 6 pikë.

Tematika që e përcjell këtë trajnim ka të bëjë me "Ndryshimet e praktikave infermierore në procesin pandemik Covid-19".



Të gjithë të interesuarit, regjistrimin mund ta bëjnë në Fakultetin e Infermierisë, në Kolegjin AAB.

Koha e mbarëvajtjes së trajnimit të paraparë, do të jetë nga ora 11:30- 13:00, kurse forma e realizimit të këtij trajnimi do të jetë përmes platformës ZOOM.

U ZHVILLUA TRYEZË VIRTUALE ME UNIVERSITETE PARTNERE NGA TURQIA

25 Mars 2021

Nën organizimin e Zyrës për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kolegjit AAB, u zhvillua një tryezë virtuale me përfaqësuesit e universiteteve partnere nga Republika e Turqisë.

Në këtë takim, rektori i AAB-së, Bujar Demjaha foli për rëndësinë e implementimit dhe intensifikimit të marrëveshjeve të arritura për të thelluar edhe më tej bashkëpunimin.

Në tryezë u fol edhe për arritjet e deritanishme në fushën e bashkëpunimit jo vetëm me institucionet arsimore nga Turqia por edhe ato evropiane.

Prorektorja Venera Llunji, foli për projektet ERASMUS+ dhe MEVLANA dhe tregoi për vështirësitë të cilat i ka hasur institucioni ynë gjatë periudhës së pandemisë.



Ajo theksoi se pandemia mund të pengojë udhëtimet fizike dhe kontaktet e drejtpërdrejta nëpër institucione të arsimit të lartë por nuk mund ta pengojë e as vështirësojë një bashkëpunim përmes përdorimit të platformave të ndryshme të komunikimit virtual.

REFORMAT NË ARSIM JANË SHUMË TË RËNDËSISHME PËR ZVOGËLIMIN E HENDEKUT TË SHKATHTËSIVE

26 Mars 2021

Prorektorja për bashkëpunim dhe marrëdhënie ndërkombëtare, Venera Llunji, ishte pjesë e forumit virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane, ku u diskutua për nevojën e reformës në arsim si dhe mungesën e shkathtësive të të rinjve të diplomuar në arsimin e lartë.

Në këtë forum virtual u tha se shkalla e papunësisë te të rinjtë në vendin tonë, vazhdon të jetë e lartë, pavarësisht numrit të lartë të të regjistruarve në arsimin universitar. Sipas panelistëve ky fakt është tregues që reflekton mospërputhjen në mes të aftësive të ofruara në tregun e punës dhe atyre që kërkohen nga punëdhënësit.



Prorektorja Llunji, duke trajtuar këtë problematikë theksoi se në një situatë të tillë nuk mund të fajësohet asnjë nivel specifikisht për hendekun e shkathtësive, sepse të gjitha nivelet e sistemit arsimor janë hallka të lidhura me njëra tjetrën.

Ajo nënvizoi situatën shqetësuese të arsimit në Kosovë, ku tha se i njëjti ka rënë drastikisht në çdo nivel, duke përmendur të ashtuquajturin analfabetizëm funksional si një faktor shumë negativ, prezent në Kosovë.

Sipas Llunjit, është mirë që të ketë bashkëpunim në mes të institucioneve të arsimit dhe bizneseve, në mënyrë që të identifikohen kërkesat e tregut dhe të krijohen programet arsimore që përputhen me të njëjtën.

KOLEGJI AAB PJESË E TAKIMIT VIRTUAL "UNIVERSITETET EVROPIANE 2030: VIZIONI DHE VLERAT", TË ORGANIZUAR NGA MAGNA CHARTA OBSERVATORY

27 Mars 2021

Prorektorja për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Venera Llunji, mori pjesë në takimin virtual "Universitetet Evropiane 2030: Vizioni dhe Vlerat", të organizuar nga Magna Charta Observatory.

Qëllimi i këtij takimi ishte analizimi i dy dokumenteve të rëndësishme të dala nga MCHO dhe Asociacioni i Universiteteve Evropiane: Magna Charta Universitatum i ri, (MCU2020) dhe raporti "Universitetet pa mure – Një vizion për vitin 2030".

Në shkurt të vitit 2021, Asociacioni i Universiteteve Evropiane, si një nga dy themeluesit e Observatorit Magna Charta, publikoi raportin e titulluar: 'Universitetet pa mure – Një vizion për vitin 2030'. Raporti bazohet në konsultime të gjera me individë, grupe ekspertësh dhe akterësh. Raporti përbëhet nga tema të tilla si: qëndrueshmëria dhe agjenda e Kombeve të Bashkuara deri në vitin 2030, transformimi digjital, situatat gjeopolitike dhe tensionet globale si dhe ndikimi i Covid 19.

Pikërisht për shkak të këtyre lëvizjeve "sizmike" dhe sfidave themelore të cilat kalojnë edhe nëpër universitete, bën që universitetet duhet të qëndrojnë të palëkundura në vlerat e tyre thelbësore, siç janë liria akademike, autonomia institucionale dhe integriteti shkencor.

Në vitin 2020 nga ky trup ndërkombëtar u nxor një dokument i ri, Magna Charta Universitatum i ri, (MCU2020), i cili i shqyrtoi dhe i mori parasysh ndryshimet në fushën e arsimit të lartë që kur dokumenti origjinal u përgatit në vitin 1988 dhe parashikoi botën me të cilën do të përballen universitetet në vitet 2020 dhe më pas.

Prof.Llunji dha kontributin e saj në trajtimin e këtyre dy dokumentet dhe mënyrën sesi universitetet, në praktikë, mund të balancojnë orientimin strategjik të veprimtarive të tyre drejt qëllimeve të mëdha shoqërore duke theksuar lirinë akademike dhe, posaçërisht, lirinë individuale të studiuesve.

KOLEGJI AAB NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME BYRONË KOSOVARE TË SIGURIMIT

30 Mars 2021

Në ambientet e Kolegjit AAB u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi në mes Kolegjit AAB dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit. Marrëveshja u nënshkrua nga rektori Dr.sc. Bujar Demjaha, dhe Sami Mazreku, drejtor ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin profesional në fushën e sigurimeve, organizimin e trajnimeve profesionale për sigurimet si: bazat e sigurimeve, menaxhimi i riskut, analiza e riskut, produktet e sigurimeve jetë dhe jo-jetë, ri-sigurimet, marketingu, kanalet e shitjes; ligjërimi i përbashkët në trajnime për ndërmjetësues në sigurime dhe trajnimet tjera profesionale.

Përveç kësaj, në sajë të kësaj marrëveshjeje palët u dakorduan për organizimin e përbashkët të tryezave debatuese dhe shkencore, ku do të trajtohen çështje me interes, si: diskutime mbi zhvillimin e tregut financiar të sigurimeve; analiza të tregut të sigurimeve dhe impakti në ekonomi; trendet në sigurime – zhvillimi i sistemeve dhe produkteve, etj..

MBAHET PUNËTORIA ME STUDENTËT E FAKULTETIT TË KOMUNIKIMIT MASIV PËR "BUXHETIMIN E PËRGJEGJSHËM GJINOR"

31 Mars 2021

Fakulteti i Komunikimit Masiv në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, të mbështetur nga UN Women, në kuadër të projektit rajonal "Financimi Transformues për Barazinë Gjinore drejt qeverisjes më transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Ballkanin Perëndimor" të financuar nga SIDA, organizuan punëtorinë me studentë me temën "Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor".

Punëtoria e organizuar me studentët e Fakultetit të Komunikimit kishte këto objektiva:

- Aftësimi i studentëve për të raportuar mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në Kosovë në një mënyrë të paanshme, të ndjeshme gjinore dhe etike.
- Forcimi i vetëdijes dhe kuptimit të pabarazive gjinore në Kosovë.
- Zgjerimi i njohurive të studentëve se si mund të trajtohen pabarazitë gjinore përmes BPGj-së.
- Mbështetja e studentëve në zhvillimin e ideve dhe metodologjive konkrete për hartimin e raporteve për BPGj.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) është një term i përdorur shpesh nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), donatorët ndërkombëtarë dhe zyrtarët e qeverisë. Që nga viti 2015, Kosova ka një kornizë të fortë ligjore që mbështetë dhe detyron të gjitha institucionet në nivelin lokal dhe qendror të zbatojnë Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor.

Përderisa BPGj është një detyrim ligjor që pritet të zbatohet nga institucionet publike, nivelet e zbatimit të tij mbeten të ulëta.

AFATI I PROVIMEVE TË PRILLIT 2020/21

FOTOGRAFIMI I ABSOLVENTËVE 2020/21

19 Mars 2021

Të dashur studentë absolventë,
ju njoftojmë se nga data 22 mars do të fillojë fotografimi i studentëve absolventë, për panon e gjeneratës.

FULBRIGHT FOREIGN STUDENT PROGRAM (PROGRAMI MASTER) TASHMË ËSHTË ËSHTË I HAPUR PËR VITIN AKADEMIK 2022-23

FULBRIGHT Kosovo

Për të gjetur thirrjen për **aplikim** kërkoni në faqen tonë (**www.aab-edu.net**) me fjalën kyqe **Fulbright**.